



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 102

Tiranë – E enjte, 9 qershor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 36/2016, datë 19.5.2016	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 104/2014, “Për caktimin e përbërjes së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”, të ndryshuar..... 5737
Vendim i Kuvendit nr. 38/2016, datë 19.5.2016	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 3/2016, “Për miratimin e përbërjes së Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore”..... 5737
Rezolutë e Kuvendit datë 19.5.2016	Për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2015..... 5737
Rezolutë e Kuvendit datë 19.5.2016	Për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2015..... 5739
Rezolutë e Kuvendit datë 19.5.2016	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2015..... 5740
Rezolutë e Kuvendit datë 19.5.2016	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2015..... 5741
Rezolutë e Kuvendit datë 2.6.2016	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për vitin 2015..... 5743
Dekret i Presidentit nr. 9622, datë 27.5.2016	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 5745
Dekret i Presidentit nr. 9623, datë 27.5.2016	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 5745

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 8.6.2016	Për dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Zhvillimit Urban, për Institutin e Ndërtimit, Tiranë, të katit përdhes, me sipërfaqe 681.5 m ² , në objektin trekatësh, komponent i pronës nr.90, me emërtim “Reparti Ushtarak nr. 4400 (Ish-Shtabi i KML-së)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë.....	5746
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 4059/2, datë 7.6.2016	Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave.....	5751
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 4262, datë 9.6.2016	Për delegim kompetence.....	5752
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 7.4.2016	<i>Çështja Aliçka dhe të tjerët kundër Shqipërisë</i> (ankimet nr. 33148/11, 33151/11, 33823/11, 46103/11, 72334/11, 78960/11).....	5753
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 2733, datë 27.5.2016	Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-Pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë (loti 8, rrugët dytësore)”, për pasuritë e llojit “truall”, “arë” dhe “ndërtim”.....	5759
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 3016, datë 27.5.2016	Për shpronësim për interes publik “Rikonstruksion dhe rikualifikim urban i lulishtes perëndimore dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka””, Berat.....	5764



VENDIM
Nr. 36/2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 104/2014, “PËR
CAKTIMIN E PËRBËRJES SË
KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR PËR REFORMËN NË
SISTEMIN E DREJTËSISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 104/2014, “Për caktimin e përbërjes së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

I. Pika I ndryshohet si më poshtë:

1.	Fatmir Xhafaj	PS	kryetar
2.	Oerd Bylykbashi	PD	zëvendëskryetar
3.	Vasilika Hysi	PS	sekretare
4.	Pandeli Majko	PS	anëtar
5.	Ulsi Manja	PS	anëtar
6.	Spartak Braho	LSI	anëtar
7.	Keltis Kruja	PD	anëtar
8.	Arben Ristani	PD	anëtar
9.	Gent Strazimiri	PD	anëtar
10.	Fatmir Mediu	PR	anëtar

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 19.5.2016

VENDIM
Nr. 38/2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 3/2016, “PËR
MIRATIMIN E PËRBËRJES SË
KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR
REFORMËN ZGJEDHORE”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 3/2016, “Për miratimin e përbërjes së Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore” bëhet ky ndryshim:

I. Deputeti Kastriot Islami caktohet anëtar në vend të deputetit Eduart Halimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 19.5.2016

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
BANKËS SË SHQIPËRISË
PËR VITIN 2015

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke vlerësuar rolin kushtetues të Bankës së Shqipërisë për zbatimin e pavarur të politikës monetare;

- Duke u mbështetur në objektivat vjetorë e afatmesëm, si dhe detyrimet ligjore të institucionit;

- Duke marrë në konsideratë ndikimin e zhvillimeve ekonomike kombëtare, rajonale e botërore në politikën monetare të ndjekur nga institucionit;

- Duke mbështetur dhe nxitur bashkëpunimin me këtë institucion;

Vlerëson veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, për vitin 2015, në këto drejtime:

1. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka qenë në përputhje me misionin dhe objektivin e saj kryesor, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Norma mesatare e inflacionit u rrit, duke iu afruar më shumë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Kjo politikë monetare ka ndihmuar në ruajtjen dhe konsolidimin e ekuilibrave makroekonomikë dhe atyre të stabilitetit financiar të vendit.

2. Në funksion të objektivit kryesor, Banka e Shqipërisë ka vijuar politikën monetare lehtësuese, duke reduktuar 3 herë gjatë vitit normën bazë të interesit. Stimuli i fortë i politikës monetare ndikoi që normat e interesit në tregjet financiare të arrijnë minimumet e tyre historike.

3. Lehtësimi i kushteve të kreditimit të ekonomisë ndikoi në reduktimin e kostove të financimit të sektorit privat dhe publik dhe në zgjerimin e kreditimit të ekonomisë në lekë.



Megjithatë, aktiviteti kreditues mbetet ende i dobët, duke u ndikuar si nga faktorë të kërkesës, ashtu edhe të ofertës.

4. Cilësia e portofolit të kredisë u përmirësua. Niveli i kredive me probleme, nga një tendencë rritëse e viteve të mëparshme, shënoi një kthesë, duke u reduktuar gjatë vitit 2015. Ndikimin kryesor e patën masat ristrukturuese, si dhe ato për nxjerrjen jashtë bilancit të bankave të kredive të humbura. Megjithatë, niveli i kredive me probleme mbetet ende i lartë.

5. Cilësia e mbikëqyrjes bankare është përmirësuar. Sektori bankar është paraqitur përgjithësisht likuid, fitimprurës, i mirëkapitalizuar dhe i aftë për të përballuar goditje të ndryshme. Kuadri rregullator dhe mbikëqyrës është përmirësuar, në drejtim të përafrimit me standardet e Komitetit të Bazelit dhe direktivat evropiane për një mbikëqyrje efektive, të bazuar në rrezik.

6. Ka pasur progres në drejtim të monitorimit dhe administrimit të rrezikut operacional.

7. Rezultati i krijuar nga administrimi i rezervës valutore ka qenë pozitiv, ndonëse në nivel të ulët, në pasqyrim të kushteve të një mjedisi me norma shumë të ulëta interesi.

8. Edhe gjatë këtij viti, ka pasur familjarizim, gjithnjë e në rritje, të tregut shqiptar me përdorimin e instrumenteve elektronike të pagesave. Megjithatë, niveli i parasë fizike në ekonomi mbetet ende i lartë.

9. Përmirësime ka pasur edhe në drejtim të proceseve të vendimmarrjes dhe të kontrollit brenda institucionit dhe, përgjithësisht, janë reflektuar rekomandimet e rezolutës së Kuvendit të vitit të mëparshëm.

Kuvendi rekomandon që Banka e Shqipërisë, për vitin 2016:

1. Të kujdeset për hartimin dhe zbatimin e politikave të përshtatshme monetare, për të ruajtur stabilitetin e çmimeve në ekonomi.

2. Banka e Shqipërisë duhet të bashkërendojë politikën e saj monetare me politikën fiskale, pa kompromentuar objektivin primar të stabilitetit të çmimeve. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë duhet të mbështesë politikën e zhvillimit ekonomik të vendit, pa kompromentuar objektivat ligjorë dhe pavarësinë institucionale të saj.

3. Banka e Shqipërisë duhet të forcojë shkëmbimin e informacionit dhe të opinionëve me institucionet e tjera publike, lidhur me zhvillimet

aktuale dhe të pritura ekonomike, si dhe me politikën ekonomike dhe reformat e nevojshme strukturore për përballimin e sfidave që kalon vendi.

4. Banka e Shqipërisë duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë nxitjes së kreditimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, si një ndër instrumentet më të rëndësishme për mbështetjen dhe zhvillimin e sektorit privat dhe të ekonomisë në përgjithësi.

5. Reduktimi i kredive me probleme duhet të vazhdojë të jetë në fokus të Bankës së Shqipërisë, pasi ndikon në rritjen e kreditimit të sektorit privat. Për këtë qëllim, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zbatimit të masave të parashikuara nga Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me FMN-në, në drejtim të falimentimit të biznesit, ekzekutimit të kolateralit, ristrukturimit të borxhit, përmirësimit të regjistrimit të kredive, trajtimit tatimor të kolateralit pas procesit gjyqësor etj.

6. Masat për reduktimin e kredive me probleme kërkojnë plotësimin dhe përmirësimin e bazës ligjore e rregullatore. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me institucionet e tjera, duhet të përgatisë përmirësimet ligjore për barrët siguruese, regjistrimin e pasurive të paluajtshme, falimentimin, Kodin e Procedurës Civile, përmbaruesit privatë, si dhe përmirësimin e kuadrit rregullator për shitjen e kredive me probleme, në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në marrëveshje me FMN-në.

7. Banka e Shqipërisë duhet të përdorë në mënyrë sa më efektive instrumentet e saj të politikës monetare, duke synuar përmbushjen e objektivave ligjorë dhe minimizimin apo shmanjen e pasojave negative në treguesit e shëndetit financiar. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë duhet të angazhohet për monitorimin e vazhdueshëm të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare dhe ndërhyrjen, apo dhënien e rekomandimeve, për përmirësimin e tij.

8. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë duhet të vazhdojë të ndjekë me përparësi çështjen e borxhit publik (të brendshëm dhe të huaj), duke zbatuar me konsekuencë metodologjinë, standardet dhe rekomandimet e FMN-së dhe të BE-së (EUROSTAT-it) për këtë qëllim, me synim për të mbështetur arritjen e objektivit të caktuar për uljen e nivelit të borxhit publik.



9. Përmirësimi i ligjit dhe kuadrit rregullator për Bankën e Shqipërisë është një detyrë tjetër e rëndësishme, që synon rritjen e pavarësisë dhe të besueshmërisë së institucionit. Ligji i ri organik duhet të hartohet në përputhje me standardet e legjislacionit evropian dhe Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

10. Banka e Shqipërisë duhet të forcojë më tej kapacitetin mbikëqyrës, duke vazhduar përafrimin me standardet më të mira ndërkombëtare dhe të vijojë politikat në drejtim të kapitalizimit të sistemit bankar, në përputhje me Bazel II.

11. Banka e Shqipërisë duhet të garantojë pavarësinë, efektivitetin dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe të administrimit të rrezikut operacional.

12. Banka e Shqipërisë duhet të kontribuojë në nxitjen e përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike dhe, si rrjedhojë, në reduktimin e përdorimit të parasë fizike në ekonomi.

13. Banka e Shqipërisë duhet të tregojë kujdes të shtuar për administrimin e rezervës së saj valutore, në kushtet kur normat e interesit në shumë segmente të tregut financiar ndërkombëtar janë në territor negativ.

14. Banka duhet të angazhohet, në vazhdimësi, në zgjerimin dhe thellimin e kulturës financiare të publikut në vend, duke pasur parasysh rëndësinë dhe peshën që ka informacioni në botën e sotme globale. Rritja e transparencës në komunikimin me publikun mbetet një detyrë e përhershme e Bankës së Shqipërisë, e cila sjell rritjen e besimit të individëve dhe bizneseve mbi sigurinë e depozitave dhe nxit kreditimin.

Miraturar në datën 19.5.2016

KRYETARI
Ilir Meta

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AGJENCISË SË SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2015

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur e vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për sigurimin dhe kompensimin e depozitave të qytetarëve, të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë;

- Duke vlerësuar kontributin e saj në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit financiar e bankar;

- Duke njohur kuadrin ligjor dhe parimet bazë, mbi të cilat mbështetet veprimtaria e Agjencisë;

- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë Agjenci, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e saj me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

Vlerëson veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në drejtim të:

- Konsolidimit të pozicionit të Agjencisë si institucion organizues, mbikëqyrës dhe realizues i procesit të sigurimit dhe kompensimit të depozitave;

- Forcimit të rolit të saj në funksion të zhvillimit të sektorit financiar dhe forcimit të stabilitetit ekonomik të vendit;

- Forcimit të rolit të saj në drejtim të edukimit dhe rritjes së besimit të publikut në bankat dhe institucionet e tjera financiare;

- Përmirësimin të kuadrit ligjor dhe rregullator, në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare;

- Forcimit të efikasitetit profesional, administrimit efikas të mjeteve e burimeve financiare, si dhe administrimit efikas të vetë Agjencisë;

- Thellimit të bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, me synim shkëmbimin e eksperiencës, forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe përmirësimin e skemës së sigurimit të depozitave;

Kuvendi kërkon që Agjencia e Sigurimit të Depozitave, për vitin 2016, të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Të zhvillojë më tej skemën e sigurimit të depozitave, të identifikojë fushat e mundshme për përmirësim, për të rritur efektivitetin dhe gatishmërinë në rast ngjarjeje sigurimi.

- Të asistojë në procesin e përgatitjes së shoqërive të kursim-kreditit, për përmbushjen nga ana e tyre të kriterëve të kërkuara, me qëllim përfshirjen e tyre të njëkohshme në skemën e sigurimit të depozitave. Të hidhet informacion për shoqëritë e kursim-kreditit në faqen *online* të Agjencisë.

- Të përmirësojë në vazhdimësi infrastrukturën informatike, për pagesën e shpejtë dhe të saktë të depozituesve, në rast të një ngjarjeje sigurimi, në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar të vendit.



- Të angazhohet në administrimin efikas të mjeteve financiare, gjetjen e mënyrave alternative të investimit, në kushtet kur normat e letrave me vlerë të Qeverisë janë në rënie, me qëllim optimizimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të fondeve të sigurimit të depozitave, në përputhje me parimet e likuiditetit dhe sigurisë.

- Të jetë e vëmendshme ndaj zhvillimeve në sistemin bankar e financiar në vend, të zhvillojë maksimalisht kapacitetet, për t'iu përgjigjur situatave të mundshme që do të kërkonin ndërhyrjen e Agjencisë.

- Të promovojë në mënyrë të vazhdueshme skemën e sigurimit të depozitave. Të rrisë nivelin e edukimit dhe ndërgjegjësimit të depozituesve për përfitimet dhe kufizimet e skemës së sigurimit të depozitave, si dhe njohjen e tyre me procedurën e kompensimit.

Miratuar në datën 19.5.2016

KRYETARI
Ilir Meta

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURENCËS PËR VITIN 2015

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës në drejtim të:

- Bashkëveprimet me aktorët e tregut dhe institucionet, kryesisht entet rregullatore, për të siguruar një ekonomi funksionale tregu;

- Ndërgjegjësimin dhe rritjes së besimit të publikut në rolin e Autoritetit në mbrojtje të konkurrencës, e shprehur nëpërmjet rritjes së numrit të çështjeve të ankimuara pranë Autoritetit të Konkurrencës;

- Rritjes së numrit të ndërhyrjeve në treg dhe zgjerimit të llojeve të tregjeve, të cilat kanë qenë objekt i monitorimit dhe hetimeve në zbatim të ligjit;

- Konsolidimit të profilit si institucion i pavarur dhe profesional dhe forcimit të kapaciteteve institucionale;

- Plotësimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor sekondar, me synim përafrimin e legjislacionit

shqiptar me atë evropian në fushën e konkurrencës.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës, për vitin 2016, të përmirësojë punën në drejtim të:

1.Ndërhyrjeve të vazhdueshme, sidomos në ato tregje, nga të cilat numri i ankesave nga aktorët është më i lartë dhe me ankesa të përsëritura çdo vit, për pretendime të sjelljeve abuzive në treg.

2.-Forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve administrative, nëpërmjet trajnimeve të inspektorëve, me qëllim rritjen e ekspertizës jo vetëm për investigimet, por edhe për analizat e thelluara ekonomike, për të identifikuar sjelljen e firmave në treg. Përmirësimin e instrumenteve hetimore, sidomos për inspektimet e befasishme, për të siguruar evidenca apo prova të mjaftueshme në rastet e kartelevë.

3.- Koordinimit me entet shtetërore për të garantuar më tepër konkurrencë në prokurimet publike dhe ndjekjen e rekomandimeve të dhëna në rastet e marrëveshjeve në oferta.

- Ndjekjes më rigorozë të proceseve gjyqësore dhe ekzekutimit të gjobave për eficiencën e ligjit të konkurrencës.

- Shtimit të vëmendjes në rastet e rritjes së çmimit për mallrat dhe shërbimet që ofrojnë koncesionarët në dëm të konsumatorëve shqiptarë.

- Informimit të vazhdueshëm të Kuvendit për aktet ligjore që kufizojnë konkurrencën dhe opinionin e Autoritetit për të drejtat ekskluzive.

- Bashkëpunimit të vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës për trajnimin e gjyqtarëve, për një njohje sa më të plotë të veçorive të ligjit të konkurrencës, si dhe të drejtës evropiane në këtë fushë, pasi është shumë i rëndësishëm arsyetimi i tyre, bazuar në interesin publik dhe vlerësimi i konkurrencës si një e mirë publike.

- Rritjen e ndërgjegjësimin të publikut për politikën antikartel nëpërmjet aktiviteteve me të tretët dhe fushatave informuese adresuar bizneseve, lidhur edhe me përfitimet që vijnë si rezultat i pjesëmarrjes në programin e lehtësimit nga gjobat.

Kuvendi u kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:



- Duke zbatuar detyrimin për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projektakt normativ që ka si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore apo cilësore të konkurrencës në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

- Për vlerësimin e efekteve reale të ndryshimit të paketës së kontrollit në eficiencën e përdorimit të aseteve të dhëna me të drejtë ekskluzive, në rastet e transferimit të kuotave nga njëri mbajtës i së drejtës tek tjetri.

- Për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

Miratuar në datën 19.5.2016

KRYETARI
Ilir Meta

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP)
PËR VITIN 2015

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke njohur AKEP-in si autoritet i pavarur në mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

- Duke e konsideruar si shumë të rëndësishëm forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale të këtij rregullatori në përmbushjen e misionit të tij, veçanërisht pas miratimit në Kuvendin e Shqipërisë të strukturës dhe organikës së re të AKEP-it;

- Duke vlerësuar që legjislacioni i ri në shërbimin postar kërkon një rregullator të fortë dhe plotësisht të pavarur, që ka kompetenca të plota në rregullimin e shërbimit postar, në veçanti në dritën e liberalizimit të këtij tregu;

- Duke vlerësuar rolin e AKEP-it në nxitjen e teknologjive të reja, të cilat sjellin rritjen e konkurrencës përmes rritjes së cilësisë, shërbimeve më të mira dhe më eficiente;

- Duke vlerësuar rolin e AKEP-it në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe përmirësimit të mbrojtjes së interesave të përdoruesve;

- Duke konsideruar strategjinë *broadband* si tepër të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve të reja në fushën e komunikimeve elektronike;

Vlerëson:

- Kontributin e AKEP-it në hartimin e ligjit të ri nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe miratimin e një sërë aktesh rregullatore në zbatim të ligjit të ri, të cilat synojnë liberalizimin gradual të tregut, rritjen e konkurrencës dhe, në mënyrë të veçantë, mbrojtjen e interesave të përdoruesve.

- Procesin e kryer për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave si një proces transparent dhe në përfitim të konsumatorëve dhe ekonomisë shqiptare, përmes të cilit u bë i mundur edhe implementimi i teknologjisë 4G në vendin tonë.

- Se hyrja në fuqi e detyrimit të operatorëve celularë për mosdiskriminim në tarifat e thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare (*on net/off net*) ka dhënë efekte pozitive në treg, duke rritur aftësitë konkurruese të dy operatorëve më të vegjël dhe duke sjellë rritje të përfitimeve për përdoruesit fundorë (konsumatorët).

- Ndërhyrjet legislative në aktet rregullatorë, të cilat bëjnë të mundur përmirësimin e procedurës së aplikimit *online* dhe të procesit të zbatuar nga subjektet e interesuara për t’u pajisur me licencë /autorizim/certifikatë.

- Analizën e tregut të telefonisë fikse, si dhe vendimet dhe masat rregulluese, të marra pas kësaj analize të rëndësishme.

- Punën e bërë në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe mbrojtjes së konsumatorit.

- Punën e bërë nga AKEP-i për arritjen e marrëveshjes kuadër mes operatorëve *mobile* dhe përcaktimin e zonave për investime të përbashkëta, për të bërë të mundur mbulimin me sinjal të disa zonave të largëta, si dhe për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar në disa zona me densitet të ulët të popullsisë. Këto investime, përveç rritjes së cilësisë së shërbimeve me akses *broadband*, synojnë rritjen e mbulimit me sinjal telefonik, duke kontribuar në këtë mënyrë në shërbimin universal në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Punën e bërë dhe përpjekjet vazhdueshme të AKEP-it për të rritur bashkëpunimin me rregullatorët e vendeve fqinje, për të shmangur në maksimum interferencat në zonat kufitare.

- Bashkëpunimin me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe inkurajon një bashkëpunim të mëtejshëm në dobi të mbrojtjes së konsumatorit.



- Punën e bërë, në bashkëpunim me OSHEE-në dhe sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike, për largimin dhe sistemimin e kabllave nga shtyllat e OSHEE-së dhe shtyllat e ndriçimit të bashkive, si një arritje e rëndësishme në uljen e rrezikshmërisë së këtyre instalimeve për jetën e personelit të sipërmarrësve, përmirësimi i mirëmbajtjes të rrjeteve të komunikimeve elektronike, por edhe rrjeteve të energjisë dhe ndriçimit.

- Ndryshimet e bëra në Planin Kombëtar të Numeracionit, ndryshime të cilat rrisin efektivitetin e përdorimit të numrave, dhe i përgjigjen ndryshimeve të mëdha demografike që kanë ndodhur në Shqipëri, zhvillimit të rrjeteve të gjeneratës së re dhe zgjerimit të zonës gjeografike për portabilitetin e numrit.

- Inspektimet e kryera të sipërmarrësve të tregut të komunikimeve elektronike dhe postare për evidentimin e rasteve të shkeljeve dhe marrjen e masave sipas legjislacionit përkatës.

- Punën e bërë nga AKEP-i në drejtim të monitorimit të spektrit të frekuencave, si dhe bashkëpunimin me AMA-n dhe Albcontrol-in për marrjen e masave ndaj subjekteve *broadcast* që shkaktojnë interferencë.

- Mbylljen me sukses të fazës së parë të “Projektit për ngritjen e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të spektrit të frekuencave”, duke bërë të mundur monitorimin 24 orë të brezit të frekuencave 20–3000 MHz, në një zonë 70 km rreth Tiranës dhe Durrësit.

- Masat e marra nga AKEP-i, lidhur me garantimin e sigurisë dhe integritetit të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Rekomandon për vitin 2016:

- Të rrisë përpjekjet në forcimin e rolit të autoritetit rregullator në mbrojtjen e konsumatorit në tregun e komunikimeve elektronike dhe në tregun postar, për të garantuar mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në tërësi nga sjelljet diskriminuese dhe antikonkurruese të operatorëve në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare.

- Të kryejë analizën e tregut të telefonisë celulare dhe të marrë vendimet përkatëse, me profesionalizëm, transparencë e paanësi, për të bërë të mundur garantimin e një tregu në mbrojtje të interesave të përdoruesve, si dhe për të garantuar një konkurrencë të ndershme dhe jodiskriminuese të operatorëve në këtë treg.

- Të rrisë më tej angazhimin institucional dhe të kërkojë me rigorozitet sigurimin e transparencës dhe publikimin e informacionit nga ana e operatorëve për përdoruesit e shërbimeve elektronike dhe postare.

- Të monitorojë cilësinë e shërbimit të telefonisë celulare në territorin shqiptar, për të gjithë operatorët, dhe rezultatet e tij të bëhen pjesë e raportimit vjetor të AKEP-it.

- Të punojë për ndjekjen dhe zbatimin e strategjisë *broadband*, duke përfshirë të gjitha detyrimet ligjore, aktet rregullatore dhe vendimet e AKEP-it, rekomandimet e ITU-së, BEREC-ut etj. në këtë strategji.

- Të marrë masat e nevojshme për implementimin e strukturës së re të AKEP-it, miratuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 88, datë 15.10.2015, duke e parë të lidhur ngushtë me rritjen e profesionalizmit dhe të pavarësisë operationale të rregullatorit.

- Bazuar në përcaktimet dhe rekomandimet ndërkombëtare, si dhe në eksperiencat më të mira, pas marrjes në administrim të spektrit 790–862 MHz, të realizojë një këshillim publik me tregun, për të bërë të mundur që, nëpërmjet çështjeve që do të trajtojnë, të arrihet maksimumi i mundshëm për të kryer një procedurë sa më transparente dhe asnjansë për dhënien në përdorim të tyre.

- Të vijojë bashkëpunimin me institucione, veprimtaria e të cilave është e lidhur dhe ndikon në çështje që kanë të bëjnë me tregun e komunikimeve elektronike dhe postare, në mënyrë të veçantë me Autoritetin e Konkurrencës.

- Të hartojë një plan veprimi të detajuar për vijimin e punës për largimin dhe sistemimin e kabllave nga shtyllat e OSHEE-së dhe shtyllat e ndriçimit të bashkive, në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin vendor, OSHEE-në dhe operatorët.

- Të vijojë punën për përmirësimin e vazhdueshëm të akteve rregullatore dhe përshtatjen me ndryshimet ligjore përkatëse, si dhe përafrimin e tyre me kuadrin rregullator të BE-së në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.

- Të vijojë punën lidhur me procesin e përmbushjes së plotë të detyrimeve ligjore dhe rregullatore të sipërmarrësve, në mënyrë që të garantojnë sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

- Të vijojë punën për plotësimin e mëtijshëm të kuadrit rregullator në fushën e shërbimeve postare,



në përmbushje të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”.

- Të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme tregun e komunikimeve elektronike, me qëllim që niveli i tarifave të thirrjeve telefonike (nga rrjete fikse dhe celulare) të jetë i përballueshëm për përdoruesit.

- Të vijojë punën për monitorimin e spektrit të frekuencave, në përputhje me aktet e miratuara.

- Të marrë masat e nevojshme për monitorimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimit postar, lidhur me zbatimin efektiv të detyrimeve ligjore, termat dhe kushtet e përgjithshme të shërbimit postar dhe kushteve thelbësore që rrjedhin nga ligji përkatës dhe aktet rregullatore të miratuara.

- Të marrë masat e nevojshme për forcimin e rolit të rregullatorit në mbrojtjen e interesave ligjorë të tregut të shërbimit postar, për të garantuar trajtimin e barabartë ligjor dhe jodiskriminues të ofruesve të shërbimeve postare në procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes tyre.

- Të marrë masat e nevojshme për përditësimin e *database*-it për rrjetin dhe për të dhënat e tjera të shërbimit postar, si dhe realizimin e projektit për publikimin e tyre në Atlasin e AKEP-it.

Miratuar në datën 19.5.2016

KRYETARI
Ilir Meta

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË
(ERE) PËR VITIN 2015

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur Entin Rregullator të Energjisë, si rregullatori i vetëm dhe i pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

- Duke konsideruar faktin që gjendja financiare në sistemin energjetik u karakterizua nga një performancë në rritje, veçanërisht në uljen e nivelit të humbjeve dhe rritjen e nivelit të arkëtimeve nga OSHEE sh.a.;

- Duke konsideruar si një aspekt shumë të rëndësishëm të punës së Entit Rregullator të Energjisë mbrojtjen e konsumatorëve;

- Duke vlerësuar se përgjegjësia e ERE-s në zhvillimin e suksesshëm të tregjeve të gazit dhe energjisë elektrike është e madhe si i vetmi ent që monitoron dhe vendos për zhvillimin e drejtë, të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm të tregut;

- Duke pasur parasysh që legjislacioni i ri dhe reforma në sektorët e energjisë dhe gazit natyror kërkon një rregullator të fortë dhe plotësisht të pavarur, që do të ketë kompetenca të plota në rregullimin e sektorit të energjisë, në veçanti në dritën e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike;

- Duke konsideruar që një liberalizim i mëtijshëm i tregut të energjisë elektrike garanton një siguri më të lartë furnizimi dhe një zhvillim më të mirë të tregut të energjisë elektrike;

Për vitin 2015:

- Vlerëson kontributin e ERE-s në hartimin e ligjit të ri nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe miratimin e një sërë aktesh rregullatore në zbatim të ligjit ri.

- Vlerëson kontributin e ERE-s në hartimin e ligjit të ri nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe miratimin e një sërë aktesh rregullatore në zbatim të ligjit ri.

- Vlerëson bashkëpunimin me Komunitetin e Energjisë, lidhur me hartimin e akteve nënligjore, për të bërë të mundur që kuadri rregullator në sektorin e energjisë, ashtu si dhe ligjet respektive të gazit natyror dhe energjisë elektrike, të reflektojnë kërkesat dhe përmbajtjen e Paketës së Tretë të Bashkimit Evropian në fushën e energjisë.

- Vlerëson rritjen e prodhimit të energjisë elektrike në vend, si pasojë e rritjes së fuqisë së instaluar të HEC-eve private, të cilat kanë filluar prodhimin.

- Vlerëson uljen e nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes, të cilat për vitin 2015 u ulën në masën 31,34 për qind kundrejt 37,81 për qind të një viti më parë.

- Vlerëson përmirësimin e treguesit të arkëtimeve të OSHEE-së, si një tregues thelbësor i performancës së kompanisë, i cili vijoi të ketë përmirësime gjatë vitit 2015, duke arritur në 98,3 për qind.

- Vlerëson punën e bërë për miratimin e Rregullores për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, pronësia e të cilit duhet të jetë e ndarë nga çdo subjekt që ushtron kontroll direkt apo të tërthortë ndaj veprimtarive të prodhimit apo furnizimit.



- Vlerëson vendimin e marrë nga ERE për certifikimin e Gazsjellësit Trans Adriatik AG (TAP-AG), si Operator i Sistemit të Transmetimit për Gaz Natyror, si një projekt me rëndësi kombëtare.

- Vlerëson bashkëpunimin e frytshëm me autoritetet rregullatore të Italisë dhe Greqisë në kuadër të Gazsjellësit Trans Adriatik.

- Vlerëson fillimin e punimeve për ndërtimin e Gazsjellësit TAP-AG, në korrik 2015, si një hap konkret dhe tepër të rëndësishëm në realizimin e këtij projekti madhor.

- Vlerëson rritjen e pagesave të kryera nga OSHEE-ja ndaj palëve të treta (kryesisht KESH sh.a. dhe OST sh.a.), e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e gjendjes financiare të tyre.

- Vlerëson bashkëpunimin me Autoritetin e Konkurrencës, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, si dhe në kuadër të hartimit të akteve nënligjore në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror.

Rekomandon për vitin 2016:

- Në veprimtarinë e tij, ERE të ketë vazhdimisht në vëmendje zbatimin e masave efektive për mbrojtjen e klientëve (konsumatorëve) të energjisë elektrike, për të pasur tarifa dhe çmime që reflektojnë kostot e drejta dhe të argumentuara për një shërbim të energjisë elektrike të pandërprerë dhe brenda standardeve të cilësisë së furnizimit.

- Të vijojë të trajtojë me seriozitet ankesat e konsumatorëve, veçanërisht të ankesave me objekt “energinë e pamatur” “mbifaturimin” dhe “faturimin aforfe”, duke kërkuar njëkohësisht një përgjegjshmëri më të lartë nga OSHEE-ja, lidhur me faturimin e saktë të konsumatorëve.

- Të monitorojë rigorozisht afatën përfundimtar të vendosjes së matësve të energjisë, për të mos lejuar faturim aforfe pas 6-mujorit të parë të vitit 2016.

- Të vijojë punën për hartimin e akteve nënligjore të nevojshme, në kuadër të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, duke mbajtur parasysh që këto akte të jenë në përputhje me Paketën e Tretë të Bashkimit Evropian në fushën e energjisë, për të bërë të mundur krijimin e një tregu konkurrues, eficient, që rrit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike në vend dhe e integron atë në tregun rajonal.

- Të vijojë punën për hartimin e akteve nënligjore të nevojshme, në kuadër të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, duke mbajtur parasysh që këto akte të jenë në përputhje me Paketën e Tretë të Bashkimit Evropian në fushën e energjisë.

- Në kuadër të miratimit të tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike, të mbajë parasysh, nga njëra anë, mbrojtjen e konsumatorit, përballueshmërinë dhe rritjen e transparencës ndaj tij dhe, nga ana tjetër, përmirësimin e treguesve, rritjen e cilësisë së shërbimit dhe performancës së kompanisë.

- Të bashkëpunojë ngushtësisht me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për të bërë të mundur sa më parë hartimin e legjislacionit për performancën e energjisë në ndërtesa dhe për burimet e energjisë së rinovueshme.

- Në kuadër të zhvillimeve bashkëkohore të sektorit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të marrë masat e nevojshme për shtimin e kapaciteteve, si dhe forcimin e profesionalizmit dhe të pavarësisë operacionale të entit.

- Të vijojë konsultimin dhe bashkëpunimin me Komitetin e Energjisë, lidhur me çështje që kanë të bëjnë me kuadrin rregullator në sektorin e energjisë, si dhe për çështje të tjera të rëndësishme të këtij sektori.

- Të vijojë monitorimin e OSHEE-së, në mënyrë të veçantë, në lidhje me transparencën në tregun e energjisë elektrike, si dhe realizimin e planit të investimeve, si dhe të kërkojë nga KESH-i, OST-ja dhe OSHEE-ja përgjegjshmëri në planifikimin e investimeve.

- Të monitorojë ecurinë e treguesve të humbjeve dhe arkëtimeve të OSHEE-së, për të bërë të mundur një vazhdimësi të përmirësimeve të arritura, të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e kompanisë, rritjen e cilësisë së shërbimit dhe shlyerjen e pagesave ndaj palëve të treta.

- Të vijojë kontributin e tij në projektin e “Masterplanit të gazit natyror për Shqipërinë dhe identifikimi i projekteve prioritare në fushën e gazit natyror”, si një projekt me rëndësi në sektorin e gazit natyror.

- Në kuadër të zbatimit të Paketës së Tretë të Energjisë, të bashkëpunojë me të gjithë aktorët për krijimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit në vendin tonë, i cili më tej duhet të



certifikohet nga ERE.

- Në kuadër të projektit TAP, si një projekt me rëndësi kombëtare, të vijoje bashkëpunimin me të gjitha institucionet brenda dhe jashtë vendit.

- Të marrë masat e nevojshme për miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për prodhuesit e energjisë nga hidrocentralet”.

- Të vijoje bashkëpunimin e tij me institucione, veprimtaria e të cilave është e lidhur dhe ndikon në çështje që lidhen me energjinë, në veçanti me Autoritetin e Konkurrencës, në drejtim të mbikëqyrjes së tregut për mbrojtjen e konsumatorit, si dhe sjelljeve apo veprimeve të mundshme antikonkurruese të pjesëmarrësve të tij.

- Të bashkëpunojë me gjithë aktorët për krijimin e kushteve të nevojshme dhe nxitjen e investimeve për instalimin e paneleve fotovoltaike, si nga individët, ashtu edhe nga bizneset, si dhe të luajë një rol proaktiv në nxitjen dhe promovimin e këtyre iniciativave.

Miratuar në datën 2.6.2016

KRYETARI
Ilir Meta

DEKRET

Nr. 9622, datë 27.5.2016

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Sebahat Hasan Koroğlu (Karakelle)
2. James Richard Amankwah
3. Shpresa Nevzat Kaba (Sadiku)
4. Aikaterini (Ekaterini) Spiridhon (Spyridon) Klostas
5. Layth Samir Jweinat
6. Dafina Shain Beqiri (Komoni)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 9623, datë 27.5.2016

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Altin Shpresim Baçi
2. Irini Biba
3. Fatmir Selim Stafa
4. Elda Spiro Dhima
5. Anda Ndriçim Halili
6. Kriarva Kristaq Dhimi
7. Klarita Sherbet Hushi (Kapllani)
8. Sabah Rasim Kopliku (Hysa)
9. Marilda Kozma Bllamo
10. Adelina Ziko Nasi
11. Etion Gori Prifti
12. Stefan Milan Krstović
13. Živko Jordan Krstović
14. Alberta Blerim Tola
15. Skënder Guro Tafa
16. Isabell Ilia Koja
17. Valbona Mentor Mërturi (Mërturi)
18. Gentiana Mentor Mërturi (Mërturi)
19. Edlira Evgein Kruja
20. Kostandina Foto Macango
21. Almita Kujtim Bejo (Zazo)
22. Edlira Shaban Fromme (Vasku)
23. Kostas Evangelos Papadhimas
24. Klodian Veli Myzyri
25. Stela Hasan Krause (Shingjini)
26. Ilda Bardhosh Baholli (Lilaj)



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 426, datë 8.6.2016

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË
PËRKOHSHËM, NGA MINISTRIA E
MBROJTJES MINISTRISË SË
ZHVILLIMIT URBAN, PËR
INSTITUTIN E NDËRTIMIT, TIRANË,
TË KATIT PËRDHES, ME SIPËRFAQE
681.5 m², NË OBJEKTIN TREKATËSH,
KOMPONENT I PRONËS NR. 90, ME
EMËRTIM “REPARTI USHTARAK
NR. 4400 (ISH-SHTABI I KML-së)”, ME
VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Zhvillimit Urban, për Institutin e Ndërtimit, Tiranë, për një periudhë 30-vjeçare, të katit përdhes, me sipërfaqe 681.5 (gjashtëqind e tetëdhjetë e një pikë pesë) m², në objektin trekatësh, komponent i pronës nr. 90, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4400 (ish-Shtabi i KML-së)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, sipas planvendosjes dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për sistemimin e administratës së

Institutit të Ndërtimit, Tiranë, me ambiente pune dhe në funksion të veprimtarisë së tij.

2. Ministrisë së Zhvillimit Urban i ndalohet të ndryshojë destinacionin e katit përdhes në objektin trekatësh, komponent i pronës me nr. 90, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4400, (ish-Shtabi i KML-së)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave i hiqet nga përdorimi i përkohshëm kati përdhes, në objektin trekatësh, sipas planimetrisë, komponent i pronës nr. 90, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4400 (ish-Shtabi i KML-së)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, miratuar me vendimin nr. 277, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes të Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të disa objekteve dhe të sipërfaqes truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 3 035.6 (tre mijë e tridhjetë e pesë pikë gjashtë) m², brenda territorit të pronës me numër rendor 90, me emërtim “Reparti ushtarak nr.4400 (ish-Shtabi i KML-së)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë”.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi




PLANVENDOSJA E
PRONES Nr.90 (ISH SHTABI I K. M. L.) TIRANE

SISTEMI I KOORDINATEVE SHETERORE











PLANIMETRIA E OBJEKTIT NR.1 KATI PERDHE

Prona nr.90 (Ish Shtabi i KML)

SHKALLA 1:150

SIP = 681.5 m²

REP.SHOQPERISE MIN. MBROJTJES LGJ.I.U.	DREJTORI	N/Kol.Ark.Ferdi HYRAJ	
Prona nr.90 "Shtabi i KML", Tirane	VIZATOI	Top. Nikoll TUSHI	
Qershor 2016	PERPILOI	Top. Edison MEMELLI	

**UDHËZIM****Nr. 4059/2, datë 7.6.2016****PËR ANONIMIZIMIN E TË DHËNAVE
PERSONALE NË VENDIMET
GJYQËSORE QË PUBLIKOHEN NË
PORTALIN ELEKTRONIK
TË GJYKATAVE**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës, në ligjin nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, në nenin 6, pika 15 dhe në nenin 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, në përputhje me rekomandimin nr. 8, datë 5.6.2013, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, të nxjerrë pas verifikimit të zbatimit të udhëzimit nr. 15, datë 23.12.2011, “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”, rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2013”, dhe rekomandimet e gjetjet e adresuara nga ekspertët e Komisionit Evropian në komentet dhe raportet e progresit për Shqipërinë, ministri i Drejtësisë:

UDHËZON:**Neni 1****Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave mbi anonimizimin e të dhënave personale që përmbajnë vendimet gjyqësore, të cilat publikohen në portalet elektronike të gjykatave.

Neni 2**Përkufizime**

Në përputhje me procedurat gjyqësore dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale për qëllim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin si vijon:

a) “Anonimizim” është procesi i fshirjes së të dhënave personale në tekstin e vendimeve gjyqësore;

b) “Gjykata” janë gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit;

c) “Portal elektronik” është baza e të dhënave, e cila nëpërmjet një programi, kryen publikimin automatik të të dhënave kompjuterike të gjykatave dhe aksesohet në linkun www.gjykata.gov.al;

d) “Vendim gjyqësor” është vendimi i dhënë nga gjykata që pasqyrohet në rubrikën “Vendim përfundimtar”, të portalit elektronik www.gjykata.gov.al.

Neni 3**Të dhënat personale**

1. “Të dhënat personale” në vendimet gjyqësore kanë të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në nenin 3, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

2. Procesit të anonimizimit i nënshtrohen të dhënat personale, që lidhen me:

a) gjeneralitetet e palëve, personave të tretë, dëshmitarëve dhe ekspertëve të thirrur në gjykim;

b) cenimin e privatësisë së palëve në gjykim (si p.sh.: adresa, targa të makinës, numra të telefonit dhe çdo element tjetër, i cili identifikon subjektin e të dhënave);

c) gjeneralitetet e palëve/aksionarëve, përqindjeve të aksioneve/kuotave që zotërojnë palët, numrave të llogarive bankare, shumat (vlerat) monetare dhe sekretet tregtare;

ç) të dhënat lidhur me të tretë, nga të cilat mund të zbulohet, edhe indirekt, identiteti i të miturit, në rastet kur ky i fundit është palë në gjykim;

d) çdo e dhënë tjetër që cenon dinjitetin dhe jetën private të palëve ose të personave të tjerë të lidhur me çështjen gjyqësore.

Neni 4**Publikimi i vendimeve gjyqësore**

Ky udhëzim zbatohet nga gjykatat që publikojnë vendimet gjyqësore në portalin elektronik të administruar nga Ministria e Drejtësisë www.gjykata.gov.al.

Neni 5**Procesi i anonimizimit**

1. Në tekstin e vendimit gjyqësor çdo e dhënë personale në kuptim të nenit 3 të këtij udhëzimi, kodohet me simbolin e kllapave “{...}”.



2. Teksti i vendimit gjyqësor, në të cilin është përdorur kodimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, hidhet në portalin e gjykatës në rubrikën “Vendim përfundimtar”.

3. Sekretari gjyqësor nën mbikëqyrjen e gjyqtarit apo të kryesuesit të trupit gjykues, vendimi gjyqësor i të cilit anonimizohet, kryen procesin e anonimizimit të të dhënave personale në tekstin e vendimit.

Neni 6

E drejta e aksesit në vendimet gjyqësore të anonimizuara

1. Portali elektronik i gjykatës publikon vetëm tekstin e vendimit gjyqësor të anonimizuar.

2. Teksti i vendimit gjyqësor, me të dhënat e plota personale, është i aksesueshëm në aplikacionin elektronik ICMIS, të instaluar në serverat e çdo gjykate vetëm nga subjektet e të dhënave personale, personat e interesuar që kanë një interes të ligjshëm, Gjykata, Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

3. Specialisti i teknologjisë së informacionit pranë gjykatës krijon fjalëkalime për përdoruesit e brendshëm të gjykatës (stafi administrativ dhe trupa gjyqësore) për të mundësuar aksesimin në vendimin gjyqësor me të dhënat e plota personale. Kancelari i gjykatës kujdeset të vendosë në dispozicion fjalëkalimin e posaçëm për aksesimin në vendimin gjyqësor me të dhëna të plota personale, subjekteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, pas depozitimit të kërkesës së argumentuar me shkrim.

4. Kopja fizike e vendimit gjyqësor të anonimizuar përfshihet në dosjen gjyqësore të çështjes përkatëse. Vetëm kopja e vendimit të anonimizuar i vihet në dispozicion personave të interesuar për përdorimin e vendimeve gjyqësore për qëllime shkencore, statistikore, literature apo gazetarie, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Neni 7

Fillimi i procesit të anonimizimit

Procesi i anonimizimi të të dhënave personale sipas këtij udhëzimi do të kryhet në vendimet gjyqësore që do të publikohen në portalin elektronik nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti.

Neni 8

Ndjekja e zbatimit dhe njoftimi i udhëzimit

1. Ngarkohen gjykatat për ndjekjen e zbatimit të këtij udhëzimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit në Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen e çështjeve teknike dhe dhënien e asistencës së nevojshme punonjësve të gjykatave për realizimin e procesit të anonimizimit të të dhënave personale.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë për njoftimin e këtij udhëzimi dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit të mundësojnë lehtësimin e zbatimit të tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani

URDHËR

Nr. 4262, datë 9.6.2016

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, nenit 7, pikës 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 28, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për datën 9.6.2016, pas orës 15:00, si dhe për datën 10.6.2016, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Arben Isaraj.

2. Ngarkohet zëvendësministri, z. Arben Isaraj, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË
NJERIUT

SEKSIONI I PARË

**ÇËSHTJA ALIÇKA DHE TË TJERËT
KUNDËR SHQIPËRISË**

(ankimet nr. 33148/11, 33151/11, 33823/11,
46103/11, 72334/11,
78960/11)

VENDIM**STRASBURG**

7 prill 2016

*Ky vendim është i formës së prerë. Ai mund t'i
nënshtrobet rishikimit redaktues.*

**Në çështjen Aliçka dhe të tjerët kundër
Shqipërisë,**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
(Seksioni i Parë), e mbledhur si një Komitet i
përbërë nga:

Kristina Pardalos, *kryetare*

Paul Mahoney,

Pauline Koskelo, *gjyqtarë,*dhe André Wampach, *zëvendësregjistrar i Seksionit,*

pasi ka diskutuar me dyer të mbyllura më 15
mars 2016,

pasi ka vërejtur se çështja ligjore në fjalë në
ankesat e mëposhtme, tashmë është objekt i
mirëpërcaktuar i praktikës gjyqësore të Gjykatës
(shiko *Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë*,
nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, 31
korrik 2012),

lëshon vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua
në po atë ditë:

PROCEDURA

1. Çështja filloi me gjashtë ankesa (nr.
33148/11, 33151/11, 33823/11, 46103/11,
72334/11 dhe 78960/11), kundër Republikës së
Shqipërisë, dorëzuar në Gjykatë, sipas nenit 34 të
Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut
dhe Lirive Themelore (Konventa), nga 13 shtetas
shqiptarë. Detajet e ankuesve dhe të përfaqësuesve
përcaktohen në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur me
vendimin.

2. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga
agjentja e saj, znj. A. Hicka nga Zyra e Avokatit të
Shtetit.

3. Më 20 dhjetor 2013, ankimet iu komunikuan
Qeverisë.

4. Në lidhje me ankimet nr. 33148/11,
33151/11, 33823/11, 46103/11 dhe 72334/11,
Qeveria nuk dorëzoi komente me shkrim për
kërkesat e ankuesve për kompensim të drejtë në
afatin kohor të lejuar.

FAKTET**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES****A. Ankimi nr. 33148/11: Aliçka dhe Vasha**

5. Më 30 maj 2003, Komisioni i Gjirokastrës
njohu, midis të tjerave, të drejtat e ankuesve për
pronën e trashëguar mbi një sipërfaqe toke me
përmasat 655,400 m². Ankuesit dhe trashëgim-
tarëve të tjerë do t'iu jepej një kompensim në
shumën prej 2,297,398 lekësh shqiptarë (TË
GJITHË) për të gjithë tokën.

6. Deri më sot, nuk është paguar asnjë
kompensim.

B. Ankimi nr. 33151/11: Kreka

7. Më 15 shtator 1995, Komisioni i Korçës
njohu, midis të tjerave, të drejtat e ankuesve mbi
një sipërfaqe toke, me përmasën prej 2,800 m², nga
e cila u rikthye 300 m². Duke qenë se sipërfaqja e
mbetur e tokës prej 2,500 m², e cila ishte e
pozicionuar brenda kufijve të fshatit dhe ishte arë,
ishte e zënë, ankuesi dhe trashëgimtarët e tjerë do
të kompensoheshin me obligacion shtetëror, në
rast se objektet e pozicionuara në sipërfaqen e
tokës nuk do të privatizoheshin. Komisioni
deklaroi se ankuesit i përkiste një e gjashta e tokës.

8. Më 21 dhjetor 1998, Komisioni i Korçës
njohu, midis të tjerave, të drejtat e ankuesve mbi
një tjetër arë dhe një tokë kullotë me sipërfaqe prej
19,796 m². Duke qenë se ara dhe kullota ishin të
zëna, ankuesi do të kompensohej në obligacione
shtetërore të barasvlershme në shumën financiare
prej 36,890 TË GJITHË.

9. Deri më sot nuk është paguar asnjë
kompensim.

C. Ankimi nr. 33823/11: Tahiri

10. Më 10 prill 1996, Komisioni i Tiranës njohu,
midis të tjerave, të drejtën e ankuesit për pronë të
trashëguar mbi një sipërfaqe toke me përmasën 766
m², nga e cila u kthye 94 m². Duke qenë se pjesa e
mbetur e tokës me sipërfaqe 672 m² ishte e zënë,
ankuesi dhe trashëgimtarët e tjerë do të kompenso-
heshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

11. Deri më sot nuk është paguar asnjë
kompensim.

**D. Ankimi nr. 46103/11: Theodhosi**

12. Më 28 gusht 2000, Komisioni i Kavajës njohu, midis të tjerave, të drejtën e ankuesit mbi pronën e trashëguar, mbi dy sipërfaqe toke të cilat në total kishin përmasën 17,500 m². Duke qenë se sipërfaqet e tokës ishin të zëna, ankuesi dhe trashëgimtarët e tjerë do të paguheshin në natyrë për sipërfaqen e tokës me përmasën 10,000 m² dhe në obligacione shtetërore për sipërfaqen tjetër me përmasë 750 m². Nuk u morr asnjë vendim për të drejtën për kompensim për pjesën e mbetur të tokës me sipërfaqe 6,750 m².

13. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

E. Ankimi nr. 72334/11: Nishe dhe të tjerët

14. Më 13 dhjetor 1996, Komisioni i Devollit njohu të drejtat e ankuesve për pronën e trashëguar mbi një sipërfaqe toke me përmasën 27,200 m². Ankuesve do t'i u akordohej kompensim me anë të obligacioneve shtetërore në shumën prej 367,000.

15. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

F. Ankimi nr. 78960/11: Benussi

16. Më 23 qershor 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtën e ankuesit për pronën e trashëguar mbi një sipërfaqe toke me përmasat 836 m², nga e cila u rikthye 513 m². Duke qenë se pjesa e mbetur e tokës ishte e zënë, ankuesi do të kompensohej në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

17. Më 17 mars 2008, Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ndryshoi pjesërisht vendimin e Komisionit dhe vendosi që ankuesi do të kompensohej në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji edhe në lidhje me sipërfaqen e tokës prej 513 m².

18. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

II. LIGJI PËRKATËS VENDAS

19. Ligji dhe praktika përkatëse vendase përshkruhen në detaje, *inter alia*, në vendimin *Ramadbi kundër Shqipërisë* (nr. 38222/02, 13 nëntor 2007); *Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, §§23–53, 31 korrik 2012) dhe i kohëve të fundit, *Sharra dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 25038/08, 64376/09, 64399/09, 347/10, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10, 33154/11 dhe 2032/12, §§33–43, 10 nëntor 2015).

III. MATERIALET E KËSHILLIT TË EVROPËS

20. Materiale të lidhura me çështjen u referuan nga vendimet e kësaj Gjykate në çështjet *Sharra dhe të tjerët*, cituar më sipër, §44, *Metalla dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 30264/08, 42129/08, 54403/08 dhe 54411/08, §§15–17, 16 korrik 2015); *Siliqi dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 37295/05 dhe 42228/05, §§12–13, 10 maj 2015); dhe *Karagozi dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 25408/06, 37419/06, 49121/06, 1504/07, 19772/07, 46685/07, 49411/07, 27242/08, 61912/08 dhe 15075/09, §§36–38, 8 prill 2014).

LIGJI**I. BASHKIMI I ANKIMEVE**

21. Duke qenë se të gjitha ankimet ngrenë të njëjtën çështje, Gjykata vendos se ato duhen bashkuar sipas rregullit 42§1 të Rregullores së Gjykatës.

II. SHKELJET E PRETENDUARA TË NENEVE 6§1 DHE 13 TË KONVENTËS, SI EDHE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. I TË KONVENTËS NË LIDHJE ME MOSZBATIMIN E VENDIMEVE TË FORMËS SË PRERË

22. Ankuesit pretendonin se ka pasur një shkelje të neneve 6§1 dhe 13 të Konventës, si edhe të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimeve vendase të formës së prerë, të cilat i akordonin atyre kompensim në vend të rikthimit të pronave të tyre.

Neni 6§1 i Konventës, për sa ka të bëjë me çështjen, parashikon si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave civile dhe detyrimeve ... çdo njeri ka të drejtën për një seancë... dëgjimore... nga [një] ... tribunal...”

Neni 13 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Çdonjëri të drejtat dhe liritë e të cilit, siç parashikohen në Konventë, janë thyer, do të përfitojë një kompensim efektiv përpara një autoriteti kombëtar, pavarësisht faktit se thyerja mund të jetë bërë nga persona me një pozicion zyrtar.”

Neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës parashikon si më poshtë:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe për kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e një shteti për të zbatuar ligje, që ai i çmon të



nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

A. PRANUESHMËRIA

1. Në lidhje me ankimin nr. 33151/11

23. Pakënaqësia e ankuesit për moszbatimin e vendimit të Komisionit në lidhje me sipërfaqen e tokës me përmasë 300 m² është e pabazuar. Për këtë arsye, Gjykata e deklaroi këtë ankesë të pabazuar dhe e rrëzon bazuar në nenin 35§§3 (a) dhe 4 të Konventës.

2. Në lidhje me ankimin nr. 46103/11

24. Ankuesja shprehu pakënaqësinë për mungesën e kompensimit në lidhje me sipërfaqen e tokës me përmasë 6,750 m² (shiko paragrafin 12 më sipër). Gjykata vëren se në mungesë të njohjes të së drejtës për kompensim nga Komisioni për atë sipërfaqe toke, ankuesja nuk mund të argumentojë se ka një “kërkesë” sipas kuptimit të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës. Gjykata e deklaroi këtë ankesë të papajtueshme *ratione materiae* dhe e kundërshtoi në përputhje me nenin 35§§3 (a) dhe 4 të Konventës.

3. Për sa ka të bëjë me ankesat e mbetura

25. Qeveria nuk ngriti ndonjë kundërshtim në lidhje me pranueshmërinë e ankesave të tjera.

26. Gjykata vëren se këto ankesa nuk janë të pabazuara, sipas kuptimit të nenit 35§3 (a) të Konventës. Më tej ajo vëren se ato nuk janë të papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Për këtë arsye, ato duhen deklaruar të pranueshme.

B. Meritat

27. Qeveria nuk i diskutoi cilësitë e pakënaqësive të ankuesve dhe pranoi se ankimet ishin praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar të Gjykatës për vendimin në çështjen *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër.

28. Për sa u përket gjetjeve të saj në çështjet e mëparshme kundër Shqipërisë, për të cilat Qeveria nuk paraqiti ndonjë argument për të garantuar distancimin e saj nga to (shiko midis të tjerave, *Çaush Driza kundër Shqipërisë*, nr. 10810/05, §§87–89 dhe §§91–94, 15 mars 2011; *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§93–97 dhe referencat cituar në të; dhe, së fundmi, *Sharra dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§49–51; *Metalla dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§29–31; *Siliqi dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§19), Gjykata konstaton se moszbatimi i vendimeve vendase të formës së prerë për kaq shumë

vite nga ana e autoriteteve vendase, shkelte të drejtat e ankuesve sipas nenit 6§1 dhe sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

29. Gjithashtu, Gjykata arrin në përfundimin se nuk ka pasur dhe se vazhdon të mos ketë asnjë kompensim efikas vendas që do të mundësonte një korrigjim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për moszbatimin e tejzgjatur të vendimeve vendase të formës së prerë, të cilat akordonin kompensim. Kështu, ka pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës (shiko *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§72–84 dhe referencat cituar në të).

III. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6§1 E KONVENTËS NË LIDHJE ME KOHËZGJATJEN E PROCEDIMEVE

30. Ankuesit në ankimin nr. 78960/11 u ankuan sipas nenit 6§1 për kohëzgjatjen e procedurave si rezultat i moszbatimit të vendimeve të Komisionit.

31. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është e pabazuar sipas interpretimit të nenit 35§3 (a) të Konventës. Më tej ajo vëren se nuk është e papranueshme në ndonjë argument tjetër dhe për këtë arsye e deklaroi atë të pranueshëm.

32. Gjykata argumenton se sipas gjetjeve në paragrafët 28–29 më sipër, çështja e kohëzgjatjes së procedurave duhet të konsiderohet se është përfshirë në çështjen e moszbatimit (shiko, për shembull, *Kutić kundër Kroacisë*, nr. 48778/99, §34, GJEDNJ 2002–II dhe *Popova kundër Rusisë*, nr. 23697/02, §44, 21 dhjetor 2006). Për këtë arsye, gjykata mendon se nuk është e nevojshme ta shqyrtojë këtë ankesë më veçantë.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

33. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Nëse Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve në të dhe nëse ligji i brendshëm i Palës së Lartë Kontraktuese në fjalë lejon që të bëhet vetëm kompensim i pjesshëm, nëse është e nevojshme, Gjykata duhet të ofrojë kompensim të drejtë për palën e dëmtuar.”

A. DËMI

1. Parashtrimet e palëve

a) Ankuesit

i) Vërejtjet e përgjithshme

34. Ankuesit bënë të njëjtat parashtrime si ato të përmbledhura në këtë vendim të Gjykatës në çështjen *Sharra dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§57–58.

*ii) Kërkesa specifike në lidhje me secilin aplikim*

35. Ankuesit patën kërkesa në lidhje me dëmin monetar dhe jomonetar, siç është paraqitur në tabelë në shtojcën 2.

36. Në lidhje me ankesën nr. 33148/11, mbështetur në raportet e ekspertit, ankuesit kërkuan që të aplikohet një çmim reference prej 5 eurosh për metër katror për tokën bujqësore me sipërfaqe 600,400 m² dhe një çmim reference prej 7.2 eurosh/m², për sipërfaqen e tokës më përmasë 55,000 m². Ata kërkuan që të zotëronin një të katërtën e të gjithë pronës.

37. Në lidhje me ankimin 33151/11, ankuesi kërkoj që të zbatohet një çmim reference prej 1,800 TË GJITHA/m² për tokën pyjore me sipërfaqe prej 8,300 m². Ai, gjithashtu, bëri kërkesë edhe për humbjen e përfitimeve referuar disa pemëve arrash. Ai kërkonte të zotëronte një të pestat e të gjithë pronës.

38. Në lidhje me ankimin nr. 33823/11, ankuesi kërkoj të zbatohet çmimi i referencës prej 24,754 TË GJITHA/m², siç edhe tregohej në hartat e vlerësimit të vitit 2008. Ai nuk bëri ndonjë kërkesë konkrete për pjesën e tij të pronës.

39. Në lidhje me ankesën nr. 78960/11, ankuesi kërkoj çmimin e referencës 120,000 TË GJITHA/m², siç përcaktohet në hartat e vlerësimit të vitit 2013. Ankuesi kërkonte që ata të zotëronin të gjithë pronën.

40. Në lidhje me ankimin nr. 46103/11, mbështetur në një raport të ekspertit, ankuesja kërkoj të zbatohet një çmim reference prej 100 eurosh/m². Ajo nuk bëri ndonjë kërkesë specifike për pjesën e saj të pronës.

41. Në lidhje me ankimin nr. 72334/11, mbështetur në një raport të ekspertit, ankuesit kërkuan të aplikohet një çmim reference prej 2,000 TË GJITHA/m². Ata kërkonin që të zotëronin të gjithë pronën.

b) Qeveria*i) Vërejtje të përgjithshme*

42. Qeveria bëri të njëjtat parashtrime si ato të përmbledhura në vendimin e kësaj Gjykate në çështjen *Sharra dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§69–71.

ii) Komente specifike në lidhje me secilin ankim

43. Në lidhje me ankimet nr. 33148/11, 33151/11, 33823/11, 46103/11 dhe 72334/11, Qeveria nuk paraqiti komente për kërkesat e ankuesve për kompensim të drejtë brenda afatit

kohor për atë qëllim (shiko, gjithashtu, paragrafin 4 më sipër).

44. Në lidhje me ankimet nr. 78960/11, Qeveria parashtrroi se ankuesi duhet të kompensohet në bazë të hartave të vlerësimit të vitit 2014, sipas së cilave çmimi i referencës ishte 57,126 TË GJITHA/m². Ata konfirmonin se ankuesi kishte të drejtën mbi të gjithë pronën.

2. Vlerësimi i Gjykatës

45. Gjykata shqyrtoi të njëjtat parashtrime të bëra nga palët në vendimin e saj në çështjen *Sharra dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§78–87. Gjykata arriti në përfundimin se dëmi monetar duhet të përcaktohet bazuar në hartat e vlerësimit të pronës të vitit 2008 (shiko *Sharra dhe të tjerët*, cituar më sipër, §90; *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, §125; dhe *Vrioni dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (kompensim i drejtë), nr. 35720/04 dhe 42832/06, §§33–39, 7 dhjetor 2010). Gjykata nuk gjen asnjë arsye për t'u distancuar nga këto gjetje.

46. Në lidhje me ankimet nr. 33148/11 dhe 72334/11, Gjykata vëren se vendimet e Komisionit kishin specifikuar shumën e kompensimit për t'u akorduar në vlerën dhe me anë të obligacioneve shtetërore. Kështu, Gjykata do t'u akordojë ankuesve shumën korresponuese, duke lënë të kuptohet se ankuesve në ankimin nr. 33148/11, u jepet e drejta mbi një të katërtën e shumës, ndërsa ankuesve në ankimin nr. 72334/11, u njihet e gjithë shumën.

47. Në lidhje me ankimin nr. 33151/11, Gjykata vëren se vendimet e Komisionit nuk njohën asnjë të drejtë mbi pronën për tokën pyjore dhe pemët e arrave (shiko paragrafët 7–8 më sipër). Për këtë arsye, Gjykata mendon se nuk duhet akorduar asnjë dëm monetar. Megjithatë, Gjykata mendon se Qeveria e paditur duhet t'i garantojë ankuesit një formë efikase kompensimi për sipërfaqet e tokës, në përputhje me vendimet e Komisionit dhe me pjesën e pronës së ankuesit, brenda tre muajve (shiko, për shembull, *Vukelić kundër Malit të Zi*, nr. 58258/09, §107, 4 qershor 2013; *Mikhaylova dhe të tjerët kundër Ukrainës*, nr. 16475/02, §40, 15 qershor 2006; dhe *Lisyanskiy kundër Ukrainës*, nr. 17899/02, §34, 4 prill 2006).

48. Në lidhje me ankimin nr. 33823/11, Gjykata gjykon që ankuesve t'u akordohet një e katërta e të gjithë pronës dhe në lidhje me ankimin nr. 78960/11 të akordohet e gjithë pronën.



49. Në lidhje me ankimin nr. 46103/11, Gjykata vëren se Komisioni akordoi kompensim me anë të obligacioneve shtetërore në lidhje me sipërfaqen e tokës me përmasë 750 m², bazuar në aktin e pronës 1993, pa e përcaktuar shumën. Megjithatë, Gjykata vëren se akti i pronës 2004, i cili shfuqizonte aktin e pronës 1993, nuk parashikon kompensim me anë të obligacioneve shtetërore. Për më tepër, kompensimi financiar është e vetmja formë kompensimi e cila aktualisht konsiderohet efikase (shiko *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§77 dhe 80). Për këtë arsye, Gjykata mendon se ankuesit i duhet akorduar kompensim financiar për sipërfaqen e tokës me përmasë 750 m².

Në lidhje me kompensimin në natyrë për sipërfaqen e tokës prej 10,000 m², Gjykata do t'i referojë parashtrimin të Qeverisë të bërë në kontekstin e procedimeve në çështjen *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, §68, sipas së cilit asnjë kompensim në natyrë nuk ishte bërë ndonjëherë efektiv. Për më tepër, ajo përsërit gjetjet e saj në çështjen *Çaush Driza*, cituar më sipër, për faktin se kjo formë kompensimi nuk ishte efikase (shiko *Çaush Driza kundër Shqipërisë*, cituar më sipër, §§77–83). Për këtë arsye, duhet akorduar kompensim financiar edhe për sipërfaqen e tokës prej 10,000 m².

Gjykata konstaton se ankuesit i duhet akorduar kompensim në lidhje me një të pesëmbëdhjetën e të dyja sipërfaqeve të tokës, në një total prej 10,750 m².

50. Për sa i përket materialit që zotëron, Gjykata e mendon të arsyeshme t'i japë shpërblyerjet për dëmin monetar dhe atë jomonetar, siç paraqitet në tabelë në shtojcën nr. 3.

B. Kostot dhe shpenzimet

51. Ankuesit bënë kërkesa në lidhje me kostot dhe shpenzimet, siç paraqitet në tabelën në shtojcën nr. 2.

52. Në lidhje me ankimet nr. 78960/11 ku citohet *Gjyli kundër Shqipërisë* (nr. 32907/07, §72, 29 shtator 2009), sipas së cilës kostot dhe shpenzimet duhet jenë të paguara faktikisht dhe domosdoshmërisht dhe të jenë të arsyeshme, Qeveria ia la çështjen në mirëbesim Gjykatës për të vendosur shumën që do të akordohet për këtë rast.

53. Sipas vendimeve të Gjykatës, “një ankues ka të drejtën të rimbursohet për kostot dhe shpenzimet vetëm për atë kohë sa tregohet se këto janë bërë në të vërtetë dhe sepse kanë qenë të nevojshme, dhe se janë të arsyeshme” (shiko *Gjyli*

kundër Shqipërisë, cituar më sipër, §72). Në këtë këndvështrim, rregulli 60 §2 dhe 3 i rregullores së Gjykatës parashikon se ankuesit duhet të bashkëlidhin me kërkesat e tyre për kompensim të drejtë “çdo dokument mbështetës të lidhur me çështjen”.

Nëse kjo gjë nuk realizohet, Gjykata “mund t'i kundërshtojë kërkesat plotësisht ose pjesërisht”.

54. Në lidhje me ankimet nr. 33148/11, 33151/11, 46103/11 dhe 72334/11, Gjykata nuk do të ofrojë kompensim për kostot dhe shpenzimet, duke qenë se nuk është paraqitur asnjë dokument mbështetës.

55. Në lidhje me gjetjet e saj në paragrafët 28–29, natyra përsëritëse e ankesave të ngritura në ankimet e mësipërme, përfaqësimi i disa prej ankuesve nga i njëjti avokat dhe këndvështrimi i Gjykatës se shumica e kostove dhe shpenzimeve të kërkuara nuk ishin të justifikueshme për kuant, Gjykata e gjykon të arsyeshme të akordojë kompensime në lidhje me kostot dhe shpenzimet, siç paraqitet në tabelën në shtojcën nr. 3.

C. INTERESI I PAPAGUAR

56. Gjykata e konsideron si të përshtatshme që norma e interesit të papaguar duhet të bazohet në normën marxhinale huadhënëse të Bankës Qendrore Evropiane, së cilës duhet t'i shtohen tre për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

1. *Vendos* t'i bashkojë të gjitha ankimet.

2. *E deklaron* të papranueshëm ankimin në lidhje me moszbatimin e vendimit në lidhje me sipërfaqen e tokës me përmasë 300 m² në lidhje me ankimin nr. 33151/11 dhe ankimin në lidhje me mungesën e kompensimit në lidhje me sipërfaqen e tokës me përmasë 6,750 m² referuar ankimit nr. 46103/11.

3. *I deklaron* ankimet e mbetura bazuar në nenet 6§1 dhe 13 të Konventës, si edhe të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimeve vendase të formës së prerë dhe kohëzgjatjen e procedurave të pranueshme.

4. *Gjykon* se ka pasur një shkelje të neneve 6§1 dhe 13 të Konventës, si edhe të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimeve vendase të formës së prerë.



5. Gjykon se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa sipas kuptimit të nenit 6§1 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave.

6. Gjykon:

a) Se shteti i paditur duhet të sigurojë, me anë të mjeteve të duhura, zbatimin e vendimeve të Komisionit të dhëna në favor të ankuesit në ankimin nr. 33151/11, për pjesën e tij të tokës, brenda tre muajve;

b) Se shteti i paditur duhet t'u paguajë ankuesve në ankimet nr. 33823/11, 46103/11 dhe 78960/11 brenda tre muajve, shumat e referuara në paragrafët 50 dhe 55 të vendimit dhe të paraqitura në tabelë në shtojcën 3, plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme, për t'u shkëmbyer në monedhën vendase në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

c) Se shteti i paditur duhet t'u paguajë ankuesve së bashku, në ankimet nr. 33148/11 dhe 72334/11 brenda tre muajve, shumat e referuara në paragrafët 50 dhe 55 të vendimit dhe të paraqitura në tabelën

në shtojcën 3, plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme, për t'u shkëmbyer në monedhën vendase në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

d) Se që nga kalimi i periudhës tremujore të sipërpërmendur deri në pagimin e kompensimit, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm në shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marxhinale huadhënëse të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonesës plus tre për qind;

7. Rrëzon pjesën e mbetur të kërkesës së ankuesve për kompensim të drejtë.

Përgatitur në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 7 prill 2016, sipas rregullit 77§§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

(Firmosur)

André Wampach
Zëvendësregjistrar

(Firmosur)

Kristina Pardalos
Presidente

SHTOJCA 1 LISTA E ANKUESVE

Nr.	Emri dhe numri i çështjes	Emri i ankuesit (viti i lindjes)	Shteti ku banojnë	Përfaqësuar nga	Data e prezantimit
1	<i>Aliçka dhe Vasha</i> nr. 33148/11	Velisha Aliçka (1940) Adriatik Aliçka (1949) Nafije Vasha, mbiemri i vajzërisë Aliçka (1942)	Shqipëri Shqipëri Shqipëri	S. Dodbiba avokat	17 maj 2011
2	<i>Kreka</i> , nr. 33151/11	Selami Kreka (1925)	Shqipëri	Asnjë	13 maj 2011
3	<i>Tabiri</i> , nr. 33823/11	Dilaver Tahiri (1944)	Shqipëri	V.Gumi avokat	24 prill 2011
4	<i>Theodhosi</i> nr. 46103/11	Afërdita Theodhosi (1951)	Shqipëri	Asnjë	6 korrik 2011
5	<i>Nishe dhe të tjerët</i> nr. 72334/11	Petraq Nishe (1938) Irimi Shkurti, mbiemri i vajzërisë Nishe (1936) Josif Nishe (1938) Ilia Çili (1954) Margarita Tole, mbiemri i vajzërisë Çili (1957) Sotir Çili (1962)	Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri	S. Dodbiba avokat	5 tetor 2011
6	<i>Benussi</i> , nr. 78960/11	Anton Benussi (1938)	Shqipëri	S. Puto, avokat	12 mars 2012



SHTOJCA 2
KËRKESAT E ANKUESVE PËR KOMPENSIM TË DREJTË, SI EDHE PËR KOSTOT DHE SHPENZIMET

Nr.	Emri dhe numri i ankimit	Dëmi monetar	Dëmi jomonetar	Kosto dhe shpenzime
1	<i>Aliçka dhe Vasha</i> nr. 33148/11	EUR849,500 në lidhje me vlerën e pronës së sipërfaqes së tokës me përmasë 655,400 m ² për pjesën e tokës që u takon ankuesve, bazuar në raportin e ekspertit	Asnjë	EUR 5,000 (nuk u dorëzua asnjë faturë)
2	<i>Kreka</i> nr. 33151/11	EUR 106,714 në lidhje me vlerën e pronës së sipërfaqes së tokës me përmasë 8,300m ² EUR 3,428 në lidhje me humbjen e përfitimeve si rezultat i prerjes së pemëve të arrave EUR 34,285 në lidhje me humbjen e përfitimeve si rezultat i ndërtimeve pa leje	Asnjë	EUR 881 (nuk u dorëzua asnjë faturë)
3	<i>Tabiri</i> nr. 33823/11	EUR 118,819 në lidhje me vlerën e sipërfaqes së tokës me përmasa 672 m ² bazuar në hartat e vlerësimit të vitit 2008, nuk u bë asnjë kërkesë specifike për këtë pjesë të pronës	EUR 10,000	EUR 8,302 (janë dorëzuar faturat)
4	<i>Theodhosi</i> nr. 46103/11	EUR 2,975,000 në lidhje me vlerën e sipërfaqes së tokës me përmasa 17,500 m ² sipas raportit të ekspertit së bashku me humbjen e përfitimeve, nuk u bë asnjë kërkesë specifike për këtë pjesë të pronës	EUR 30,000	EUR 15,000 (nuk u dorëzua asnjë faturë)
5	<i>Nishe dhe të tjerët</i> nr. 72334/11	EUR 395,000 në lidhje me vlerën e tokës bujqësore me sipërfaqe prej 27,200m ² sipas raportit të ekspertit	EUR 16,000	EUR 5,000 (nuk u dorëzua asnjë faturë)
6	<i>Benussi</i> nr. 78960/11	EUR 716,571 në lidhje me vlerën e tokës me sipërfaqe 836 m ² sipas hartave të vlerësimit të vitit 2013	EUR 15,000	EUR 1,000 (janë dorëzuar faturat)

SHTOJCA 3
VENDIMI I GJYKATËS

Nr.	Emri dhe numri i ankimit	Dëmi monetar dhe dëmi jomonetar	Kosto dhe shpenzime
1	<i>Aliçka dhe Vasha</i> nr. 33148/11	EUR 3,200 (tre mijë e dyqind)	Asnjë (nuk u dorëzua asnjë faturë)
2	<i>Kreka</i> , nr. 33151/11	Asnjë	Asnjë (nuk u dorëzua asnjë faturë)
3	<i>Tabiri</i> , nr. 33823/11	EUR 34,300 (tridhjetë e katër mijë e treqind)	EUR 850 (tetëqind e pesëdhjetë)
4	<i>Theodhosi</i> , nr. 46103/11	EUR 11,800 (njëmbëdhjetë mijë e tetëqind)	Asnjë (nuk u dorëzua asnjë faturë)
5	<i>Nishe dhe të tjerët</i> nr. 72334/11	EUR 31,300 (tridhjetë e një mijë e treqind)	Asnjë (nuk u dorëzua asnjë faturë)
6	<i>Benussi</i> , nr. 78960/11	EUR 719,000 (shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë)	EUR 850 (tetëqind e pesëdhjetë)

KËRKESË

Nr. 2733, datë 27.5.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën, “Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-Pass Plepa-Kavajë-Rrogzhinë (loti 8, rrugët dytësore)”, për pasuritë e llojit “trull”, “arë” dhe “ndërtim”.

Subjekti kërkues, i këtij objekti, është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken

nga ky shpronësim. Vënia në dijeni, konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen,



titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit “truall”, “arë” dhe “ndërtim”. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është 26 245 455 (njëzet e gjashtë milionë e dyqind e dyzet e pesë mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë) lekë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË SË TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Eduart Seitaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PASURITË E TË CILËVE PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR “BY-PASS PLEPA-KAVAJË-RROGOZHINË (LOTI 8, RRUGËT DYTËSORE)”

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Z.K	Nr. pas	Sip. totale (m ²)	Lloji i pasurisë	Sip. arë (m ²)	Sip. truall (m ²)	Çmimi	Vlera	Shënime
1	Ramazan	Vath	Kerçuku	1212	162/1	1900	arë	142		329	46,718	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Dylaver	Idajet	Tafa	1212	162/26	1050	arë	230		329	75,670	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Zyhra	Kadri	Lilamani	1212	162/27	1050	arë	205		329	67,445	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Shpetim	Kadri	Qerosi	1212	162/29	1325	arë	268		329	88,172	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Fikri	Liman	Alushi	1212	162/30	1325	truall		212	1880	398,560	Barrë hipotekare
6	Safet	Mustafa	Lilamani	1212	162/17	467.8	arë	87		329	28,623	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	B/pronarët	Banushi		1212	162/18	2253.8	arë	357		329	117,453	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Marjan	Ymer	Guga	1212	162/19	1786	arë	468		329	153,972	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Ndriçim	Sulejman	Kullolli	1212	162/23	1355	arë	359		329	118,111	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	Shpetim	Kadri	Qerosi	1212	162/25	3500	arë	379		329	124,691	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	Nafije		Cara	1212	162/36	6950	arë	138		329	45,402	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	Ilir	Tahir	Sinameta	1212	162/38	1752	arë	257		329	84,553	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	Islam	Mersin	Kumria	1212	162/40	663	arë	258		329	84,882	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
14	Ilir	Tahir	Sinameta	1212	162/41	1956	arë	250		329	82,250	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
15	Islam	Mersin	Kumria	1212	162/43	436	arë	248		329	81,592	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
16	Arben	Zyber	Cela	3817	14/1	1000	arë	8		329	2,632	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
17	Arben	Zyber	Cela	3817	14/24	1400	arë	123		329	40,467	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
18	Rifon	Selim	Hoxha	3817	14/25	100	arë	23		329	7,567	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
19	Arben	Zyber	Cela	3817	14/22	780	arë	85		329	27,965	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
20	Fehmi	Mustafa	Hoxha	3817	14/4	2000	arë	342		329	112,518	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
21	Rifat	Shaqir	Cepeli	3817	14/5	800	arë	108		329	35,532	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
22	Mirsin	Gani	Cepeli	3817	14/6	1000	arë	190		329	62,510	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
23	Gani	Shaqir	Cepeli	3817	14/7	1000	arë	169		329	55,601	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
24	Vasil	Ibrahim	Cepeli	3817	14/8	500	arë	99		329	32,571	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
25	B/P Cepeli			3817	14/9	900	arë	120		329	39,480	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
26	Ali	Hasan	Shehi	3817	14/21	2640	arë	131		329	43,099	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
27	Bardhyl	Riza	Tola	3817	14/34	3000	truall		406	1970	799,820	Certifikatë pronësie
28	B/p Tola			3817	14/39	500	truall		114	1970	224,580	Certifikatë pronësie
29	Idriz	Besim	Elezi	3817	14/14	10320	arë	523		329	172,067	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
30	Xhevat		Elezi	3817	14/31	1000	arë	88		329	28,952	I pakonfirmuar
31	B/p Elezi			3817	14/32	7170	arë	129		329	42,441	I pakonfirmuar
32	Shkelzen	Aqif	Hoxha	3817	14/20	800	arë	136		329	44,744	konfirmuar ZVRPP
33	Shkelzen	Aqif	Hoxha	3817	14/27	630	arë	102		329	33,558	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
34	Petrit	Besim	Elezi	3817	14/36	927	arë	115		329	37,835	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
35	Bashkim		Elezi	3817	15/27	7750	arë	56		329	18,424	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
36	Bashkepron arët Elezi			3817	15/4	6360	arë	350		329	115,150	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
37	Isuf	Taip	Ismaili	3817	15/5	6000	arë	397		329	130,613	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
38	Nazmi	Idriz	Hoxha	3817	15/6	5560	arë	288		329	94,752	Konfirmuar nga ZVRPP-ja



39	Agim		Hoxha	3817	15/7	1490	arë	95		329	31,255	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
40	B/p Haka			3817	15/8	8270	arë	830		329	273,070	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
41	Bardhyl	Latif	Haka	3817	15/9	9600	arë	998		329	328,342	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
42	Jakup	Rizvan	Hoxha	3817	15/10	1490	arë	180		329	59,220	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
43	Agim	Aqif	Lecini	3817	15/11	1490	arë	180		329	59,220	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
44	Mehmet	Vath	Arapi	3817	15/12	2130	arë	233		329	76,657	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
45	Rifat	Mersin	Hoxha	3817	15/13	1490	arë	168		329	55,272	I pakonfirmuar
46	Bardhyl	Riza	Tola	3817	15/25	865	truall		220	1970	433,400	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
47	Gezim	Murat	Bagosi	3817	15/24	1170	arë	256		329	84,224	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
48	Taip		Bagosi	3817	15/22	2330	arë	376		329	123,704	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
49	Kujtim	Mahmud	Kurti	3817	15/21	2070	truall		327	1970	644,190	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
50	Dashamir	Mahmud	Kurti	3817	18/68	2567	arë	558		329	183,582	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
51	Dritan	Bujar	Ibra	3817	18/65	1500	arë	237		329	77,973	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
52	Reshat	Eqerem	Hallulli	3817	18/66	1500	arë	202		329	66,458	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
53	Qazim	Roc	Cepeli	3817	18/2	3000	arë	507		329	166,803	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
54	Sali	Asllan	Cepeli	3817	18/44	3830	arë	320		329	105,280	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
55	Ismail		Cepeli	3817	18/114	3242	arë	399		329	131,271	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
56	B/pronarët Caca			3817	18/49	1900	arë	198		329	65,142	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
57	Estref	Isak	Caca	3817	18/47	1300	arë	120		329	39,480	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
58	Estref		Caca	3817	18/51	1010	arë	71		329	23,359	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
59	Bisha	Osman	Hoxha	3817	18/8	1200	arë	229		329	75,341	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
60	Murat	Haqim	Celhaka	3817	18/86	2280	arë	202		329	66,458	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
61	Murat	Haqim	Celhaka	3817	18/81	1870	arë	159		329	52,311	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
62	Murat	Haqim	Celhaka	3817	18/102	4900	truall		620	1970	1,221,400	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
63	Bajram	Alush	Hoxha	3817	18/97	430	arë	430		329	141,470	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
64	Idriz	Riza	Zella	3817	18/92	2404	arë	464		329	152,656	I pakonfirmuar
65	Idriz	Riza	Zella	3817	18/93	2404	arë	259		329	85,211	I pakonfirmuar
66	Idriz	Riza	Zella	3817	18/94	2404	arë	321		329	105,609	I pakonfirmuar
67	Idriz	Riza	Zella	3817	18/95	2404	arë	370		329	121,730	I pakonfirmuar
68	Vullnet		Dedja	3817	18/110	1525	truall		553	1970	1,089,410	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
69	Vullnet		Dedja	3817	18/111	60	arë	39		329	12,831	I pakonfirmuar
70	Rozeta	Xhafer	Baha	3817	18/64	2970	truall		1027	1970	2,023,190	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
71	Bilal	Alush	Hoxha	3817	18/72	2185	arë	185		329	60,865	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
72	Kalem	Qazim	hoxha	3817	18/63	940	arë	45		329	14,805	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
73	Bashkepron arët Hoxha			3817	18/18	5360	arë	52		329	17,108	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
74	Kalem		Hoxha	3817	18/17	3000	arë	113		329	37,177	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
75	Bashkim		Hoxha	3817	18/104	1661	arë	196		329	64,484	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
76	Bashkim		Hoxha	3817	18/107	429	arë	45		329	14,805	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
77	Fatos	Vesel	Catri	3817	17/36	1470	arë	9		329	2,961	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
78	Hajdar	Zenun	Catri	3817	17/37	1470	arë	23		329	7,567	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
79	B/Pronesi			3817	17/38	1470	arë	57		329	18,753	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
80	Fatos	Vesel	Catri	3817	17/39	1180	arë	85		329	27,965	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
81	Zenel	Ramazan	Catri	3817	17/40	1177	arë	86		329	28,294	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
82	Ramazan	Xheladin	Catri	3817	17/41	1470	arë	135		329	44,415	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
83	Sejdin	Ismail	Catri	3817	17/42	2155	arë	108		329	35,532	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
84	Sejdin	Ismail	Catri	3817	17/43	785	arë	101		329	33,229	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
85	Pellumb	Besnik	Ninga	3817	17/220	441	truall		325	1970	640,250	Certifikatë pronësie
86	Skender	Taip	Camema	3817	17/229	1990	arë	191		329	62,839	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
87	B/Pronarët Hoxha			3817	17/47	1755	arë	94		329	30,926	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
88	B/Pronarët Hoxha			3817	200/27	2448	arë	137		329	45,073	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
89	B/Pronarët Hoxha			3817	17/199	1350	arë	129		329	42,441	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
90	Skender	Taip	Camema	3817	17/224	962	arë	247		329	81,263	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
91	Haki		Hoxha	3817	17/50	3090	arë	305		329	100,345	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
92	Shoqëria Varvara sh.p.k			3817	17/155	4560	arë	414		329	136,206	I pakonfirmuar
93	Shoqëria Varvara sh.p.k			3817	17/163	1140	arë	182		329	59,878	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
94	Shoqëria Varvara sh.p.k			3817	17/161	1600	arë	163		329	53,627	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
95	Shoqëria Varvara sh.p.k			3817	17/165	1420	arë	186		329	61,194	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
96	Hilmi	Taip	Hoxha	3817	17/59	3280	arë	286		329	94,094	Konfirmuar nga ZVRPP-ja



97	Bajram	Lush	Nasufi	3817	17/187	1990	arë	70		329	23,030	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
98	Gezim	Sherif	Hoxha	3817	17/232	1539	arë	752		329	247,408	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
99	Dervish	Halil	Hoxha	3817	17/102	1665	arë	1665		329	547,785	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
100	Shpetim	Hasim	Hoxha	3817	17/261	726	arë	451		329	148,379	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
101	Bardhyl		Hoxha	3817	17/264	850	arë	62		329	20,398	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
102	B/Pronarët Hoxha			3817	17/221	488	arë	12		329	3,948	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
103	Fiqiri	Latif	Hoxha	3817	17/246	2453	arë	109		329	35,861	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
104	Fiqiri	Latif	Hoxha	3817	17/273	2140	truall		116	1970	228,520	Barër hipotekare
105	Nesret		Hoxha	3817	17/289	670	arë	64		329	21,056	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
106	B/Pronarët Hoxha			3817	17/292	914	arë	105		329	34,545	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
107	Artur	Ismail	Velu	3817	17/178	1220	truall		117	1970	230,490	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
108	Aida	Xhavit	Ajdini	3817	17/180	530	arë	72		329	23,688	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
109	Behar	Remzi	Ajdini	3817	17/181	485	arë	75		329	24,675	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
110	B/Pronarët Metolli			3817	17/278	2300	truall		520	1970	1,024,400	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
111	B/Pronarët Hoxha			3817	17/184	1650	truall		239	1970	470,830	Certifikatë pronësie
112	Fatbardh	Halil	Muca	3817	17/233	1430	arë	101		329	33,229	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
113	Bujar	Rexhep	Shahinelli	3817	17/101	675	arë	388		329	127,652	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
114	Shpetim		Hoxha	3817	17/259	420	arë	420		329	138,180	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
115	Bardhyl		Hoxha	3817	17/262	490	arë	490		329	161,210	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
116	Mirjan		Hoxha	3817	17/225	1269	arë	475		329	156,275	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
117	B/Pronarët Hoxha			3817	17/170	760	arë	84		329	27,636	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
118	B/Pronarët Hoxha			3817	17/251	240	arë	138		329	45,402	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
119	Mirjan		Hoxha	3817	17/294	1279	arë	1279		329	420,791	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
120	Pellumb	Bajram	Cullhaj	3817	17/266	2840	truall		679	1970	1,337,630	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
121	Mendrin		Dervishi	3817	17/245	3147	truall		197	1970	388,090	Certifikatë pronësie
122	Nexhmi	Kadri	Hoxha	3817	17/150	950	arë	91		329	29,939	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
123	Nexhmi	Kadri	Hoxha	3817	17/152	1100	arë	85		329	27,965	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
124	Mirjan		Hoxha	3817	17/167	890	arë	50		329	16,450	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
125	Edmond	Jorgji		3817	17/265	3860	arë	274		329	90,146	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
126	Osman	Alush	Hoxha	3817	17/173	2810	arë	1667		329	548,443	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
127	Veli	Rexhepi		3817	17/286	2393.4	arë	309		329	101,661	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
128	Julian		Hoxha	3817	17/287	1705	arë	144		329	47,376	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
129	Dorian		Hoxha	3817	17/288	1704	arë	132		329	43,428	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
130	Banka e Tiranës sh.a			3817	17/194	960	arë	128		329	42,112	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
131	Banka e Tiranës sh.a			3817	17/197	640	arë	104		329	34,216	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
132	Kasem	Sadi	Hoxha	3817	17/289	814	arë	78		329	25,662	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
133	Fatmir	Qemal	Bego	3817	100/19	1080	truall		170	1970	334,900	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
134	Durim	Qemal	Bego	3817	100/18	1020	truall		170	1970	334,900	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
135	Jakup	Rizvan	Hoxha	3817	100/1	1800	arë	91		329	29,939	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
136	Qemal	Beqir	Hoxha	3817	100/6	3000	arë	114		329	37,506	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
137	Zylf	Shyqyri	Hoxha	3817	100/7	3001	arë	100		329	32,900	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
138	Xhevdet	Behexhet	Hoxha	3817	100/8	1300	arë	114		329	37,506	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
139	Agim	Musa	Muzhaqi	3817	101/20	7960	arë	400		329	131,600	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
140	Osman	Xhemali	Hoxha	3817	101/9	2290	arë	123		329	40,467	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
141	B/Pronesi			3817	101/10	1500	arë	95		329	31,255	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
142	Agim	Musa	Muzhaqi	3817	101/16	600	arë	41		329	13,489	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
143	Hajdar	Ymer	Hoxha	3817	101/17	1000	arë	41		329	13,489	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
144	Zyber	Kapllan	Hoxha	3817	101/12	2100	arë	104		329	34,216	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
145	Albert	Gezim Telhaj		3817	101/19	1500	truall		134	1970	263,980	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
146	Mahmut	Nebi	Muca	3817	39	1050	arë	334		329	109,886	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
147	Resmi	Jakup	Mallulli	3817	40/2	1500	arë	57		329	18,753	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
148	Xhevdet	Jakup	Mallulli	3817	40/3	1500	arë	134		329	44,086	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
149	Bisma	Myrteza	Mallulli	3817	40/4	3000	arë	134		329	44,086	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
150	SHKELZE N		ISTERI	3427	46/25	6400	truall		238	327	77,826	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
151	HAJDIJE	YMER	ISMAILI	3427	46/2	4900	truall		180	327	58,860	Barër hipotekare
152	RESHAT	SABRI	ISUFI	3427	46/28	4080	truall		163	327	53,301	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
153	ILIR	VESEL	HOXHA	3427	46/22	1000	arë	183		329	60,207	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
154	ILIR	VESEL	HOXHA	3427	46/35	5610	arë	186		329	61,194	Barër hipotekare
155	NEZIR	RESHIT	HOXHA	3427	46/36	6290	arë	183		329	60,207	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
156	GENCI	SALI	CEPELI	3427	46/33	4125	arë	140		329	46,060	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
157	NAZMI	SALI	CEPELI	3427	46/34	4125	arë	154		329	50,666	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
158	DURIM		CEPELI	3427	46/30	4125	arë	136		329	44,744	Konfirmuar nga ZVRPP-ja



159	SHOQ.AGRO BLEN SH.P.K.			3427	46/37	771	truall		98	327	32,046	Barrë hipotekare
160	SHOQ.AGRO BLEN SH.P.K.			3427	46/39	4498	truall		366	327	119,682	Barrë hipotekare
161	Mersin	Hysen	Sinameta	3427	46/11	7000	arë	273		329	89,817	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
162	Mersin	Hysen	Sinameta	3427	46/12	1920	arë	152		329	50,008	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
163	Mersin	Hysen	Sinameta	3427	46/41	4750	truall		390	327	127,530	Barrë hipotekare
164	Bashkepron arët Veizi			3427	46/23	2016	arë	165		329	54,285	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
165	Edmond	Jorgji	Lusha	3427	46/15	1560	arë	157		329	51,653	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
166	Lutfi	Hysen	Meta	3427	.5/30	5000	arë	344		329	113,176	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
167	Seid	Zenun	Kamberi	3427	.5/31	14950	arë	872		329	286,888	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
168	Gezim	Reshit	Kamberi	3427	.5/32	3500	arë	374		329	123,046	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
169	Nejre	Masar	Belegu	3427	.5/9	6600	arë	263		329	86,527	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
170	Nexhmije	Masar	Murati	3427	.5/10	6600	arë	179		329	58,891	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
171	Xhemile	Masar	Myftiu	3427	.5/11	6600	arë	190		329	62,510	Barrë hipotekare
172	Osman	Regip	Babamusta	3427	.5/12	6600	arë	193		329	63,497	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
173	Bashkim	Masar	Harizi	3427	.7/15	720	arë	63		329	20,727	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
174	Shyqyri	Alush	Duraku	3427	.7/17	16370	truall		618	327	202,086	Barrë hipotekare
175	Fatmir	Bajram	Okshuni	3427	44/10	3810	arë	625		329	205,625	Barrë hipotekare
176	Irfan	Hamdi	Çurumi	3427	.4/3	675	arë	354		329	116,466	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
177	Irfan	Hamdi	Çurumi	3427	.4/4	680	arë	334		329	109,886	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
178	Kalem	Mersin	Bushi	3427	.5/25	96	arë	59		329	19,411	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
179	Kalem	Mersin	Bushi	3427	.5/23	96	arë	47		329	15,463	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
180	Kalem	Mersin	Bushi	3427	.5/21	88	arë	36		329	11,844	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
181	Kalem	Mersin	Bushi	3427	.5/19	136	arë	30		329	9,870	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
182	Elena	Bashkim	Ullorja	3427	41/5	1330	arë	76		329	25,004	Barrë hipotekare
183	Elena	Bashkim	Ullorja	3427	42/1	1360	arë	60		329	19,740	Barrë hipotekare
184	Dyrr	Izet	Collaku	3427	42/2	3000	truall		101	327	33,027	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
185	Astrit	Musa	Muzhaqi	3427	42/3	4480	arë	152		329	50,008	Barrë hipotekare
186	Astrit	Musa	Muzhaqi	3427	43/1	1460	arë	51		329	16,779	Barrë hipotekare
187	Mendi	Sabri	Hoxha	3427	43/2	2982	arë	82		329	26,978	Barrë hipotekare
188	Xhaferr	Durim	Hylviu	3427	43/5	3930	arë	78		329	25,662	Barrë hipotekare
189	Sami	Ramazan	Tufa	3427	43/20		arë	54		329	17,766	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
190	Eduart	Mihal	Simaku	3427	43/21	2405	arë	6		329	1,974	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
191	Eduart	Mihal	Simaku	3427	43/7	3000	arë	23		329	7,567	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
192	Shpresa	Qazim	Kazazi	3427	43/8	2970	truall		13	327	4,251	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
193	Namir	Halim	Cela	3427	43/9	1522	truall		43	327	14,061	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
194	Durim	Ymer	Togu	3427	43/10	2972	arë	74		329	24,346	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
195	Shoqëria Sinameta Sh.p.k			3427	43/23	10608	arë	386		329	126,994	Barrë hipotekare
196	Artan	Zenun	Sinameta	3427	43/19	4200	truall		126	327	41,202	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
197	Agron	Dilo	Korani	3427	25/6	1150	arë	185		329	60,865	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
198	Bardhyl	Khavit	Bushi	3427	25/5	1000	arë	209		329	68,761	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
199	Perparim	Khavit	Bushi	3427	25/4	930	arë	142		329	46,718	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
200	Ismet		Bushi	3427	25/3	1020	arë	86		329	28,294	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
201	Bashkim	Masar	Harizi	3427	26/2	1330	arë	78		329	25,662	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
202	Agim	Dogjan	Dogjani	3427	26/7	5270	truall		160	327	52,320	Barrë hipotekare
203	Xhemal	Bajram	Danaj	3427	27/3	870	arë	8		329	2,632	Barrë hipotekare
	TOTALI										25,538,661	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PASURITË E TË CILËVE PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “BY-PASS PLEPA-KAVAJË-RROGOZHINË (LOTI 8, RRUGËT DYTËSORE)”

Nr. rendor	PRONARI			Z. Kadastrale	Nr. pasurie	Objekti i shpronësimit	kostos së ndërtimit (lekë)	VLERA TOTALE (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri						
1	Hajdije	Ymer	Ismaili	3427	46/2	shesh ndërtimi	706,794	706,794	Konfirmuar nga ZVRPP-ja

KËRKESË

Nr. 3016, datë 27.5.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion dhe rikualifikim urban i lulishtes perëndimore dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka”” Berat.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Berat.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të

llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar për pronarët, sipas listës emërore, bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 19,017,035 (nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëmbëdhjetë mijë e tridhjetë e pesë) lekë.

ZËVENDËSMISTRI I ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi

TABELA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION DHE RIKUALIFIKIM URBAN I LULISHTES PERËNDIMORE (LOTI OPSIONAL) DHE SUPLEMENTI I SHESHIT QENDROR “TEODOR MUZAKA””
(LOTI 3 PJESOR)

Nr.	Pronari		Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Lloji i ndërtimit	Sipërfaqja		Çmimi		Vlera		Vlera gjithsej truall + ndërtësë
	Emër	Mbiemër				Truall m ²	Ndërtësë m ²	Truall lekë	Ndërtësë lekë	Truall lekë	Ndërtësë lekë	
1	Refat	Cobo	8502	11/153N1	Njësi	80	160	4183	situacion	334640	9173877.62	9508517.62
2	Shokie	Isufi	8502	11/153N2	Njësi	80	160	4183	situacion	334640	9173877.62	9508517.62
												19017035.24

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë